



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0760

PSH. nr. 760/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) “MBB Construction” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi i Cerdhes ne Rogove” me nr. të prokurimit: “632-23-7376-5-2-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakoves, me datën 21.12.2023, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “MBB Construction” SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 05.10.2023 (me numër protokolli 760/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi i Cerdhes ne Rogove “ me nr. të prokurimit: “632-23-7376-5-2-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakoves.

2. Aktiviteti i prokurimit i sipërcekur anulohet në tërësi.

3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 24.07.2023, Komuna e Gjakoves , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi i Cerdhes ne Rogove” me

nr. të prokurimit: "632-23-7376-5-2-1". Nderkaq me datën 05.09.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE "MBB Construction" SH.P.K me datën 19.09.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me 27.09.2023, AK- Komuna e Gjakoves me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE "MBB Construction" SH.P.K. . lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i Cerdhes ne Rogove" me numër të prokurimit: 632-23-7376-5-2-1 inicuar nga Autoriteti Kontraktues.

AK ne vendim ka kërkuar të refuzohet kërkesa e propozuar për shqyrtim si e pa baze.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "MBB Construction" SH.P.K. me datën 05.10.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 760/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 299.999.90 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 18.10.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "MBB Construction" SH.P.K.

I. Aprovohet, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "MBB Construction" SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 05.10.2023 (me numër protokollit 760/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i Cerdhes ne Rogove " me nr. të prokurimit: "632-23-7376-5-2-1", inicuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakoves.

II. Lenda të kthehet në RIVLERESIM.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Pretendimin ankimor 1

OE ankues thekson se: Fillimisht ju sqarojmë se arsyeja e eliminimit tonë është e pa bazuar dhe e paqëndrueshme, sepse çmimi i dhënë në pikën 1.16 Punet e Parterit dhe Fushlojave është i

llogaritur në totalin e çmimit të ofruar nga ne. Në ofertën tonë nuk egziston asnjë lëshim as tek plotësimi i çmimeve e as tek përlllogaritja e tyre, por ne e kemi plotësuar paramasën dhe parallogarinë ashtu siç është përgatitur nga ana e AK-së. Tek rekapitulimi nuk është vendosur asnjë kolon për punët e Parterit dhe fushëlojave, mirëpo në çmimin që e kishim vendosur tek pozicioni 1.16 e kemi përlllogaritur dhe e kemi përfshi në totalin e ofertës.

Tek Rekapitulimi nuk është vendosur asnjë kolon në Punët e Parterit dhe fushëlojave, mirëpo ne çmimin që e kishim vendosur tek pozicioni 1.16 e kemi përlllogaritur dhe e kemi përfshirë në totalin e ofertës.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1

Pas analizimit të dokumentacionit të ofruar në E prokurim për këtë aktivitet të prokurimit, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka plotësuar paramasën me çmime sipas paramasës së ofruar nga Autoriteti Kontraktues.

Paramasa e AK-së tek Rekapitulimi Punet Ndërtimore (pozicioni 1.01- pozicioni 1.18) u mungojnë rreshtat pozicioni 1.15 dhe pozicioni 1.16, mirëpo tek Punët Ndërtimore totali me tvsh AK ka parapar me formulë mbledhjen e të gjitha puneve Ndërtimore të paraqitura në paramasë.

Eksperti Shqyrtues, sqaron se nuk mund të konsiderohet i pa përgjeshëm OE ankues, për arsye se i njëjti ka plotësuar paramasën me çmime e tij për pozicione, dhe tek Punët ndërtimore totali me TVSH është i përfshir edhe pozicioni 1.15 dhe 1.16.

Eksperti Shqyrtues, ka bërë mbledhjen e të gjitha pozicioneve duke filluar nga Pozicioni 1.01 deri tek pozicioni 1.18 dhe gjatë mbledhjes rezulton në shumën e njëjtë të cilën OE ankues e ka ofruar te Rekapituli i punëve ndërtimore i cili është i emërtuar si Totali me TVSH.

Eksperti Shqyrtues e konsideron pretendimin e OE ankues si të bazuar dhe vleron se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, për faktin se OE ankues i është përmbajt paramasës së ofruar nga vetë AK, dhe në të njëjtën janë të përfshira edhe punët e parterit dhe fushëlojave për të cilën është eliminu OE ankues.

Në vijim gjeni të bashkangjitur si moster pjesë nga paramasa e AK-së.

Pretendimin ankimor 2

OE ankues thekson se pas qasjes në dokumentacion, ne kemi analizuar ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe kemi vërejtur se i njëjti OE ka shtuar një kolonë tek rekapitulimi dhe e ka vendos çmimin e pozicionit 1.16. Ky OE realisht ka bërë ndërhyrje në paramasë, prandaj duhet të shpallet i pa përgjegjshëm për këtë ndërhyrje. Paramasa e dizajnuar dhe e përpiluar nga autoriteti kontraktues nuk lejohet që të preket dhe të ndërhyet. Në këtë rast ka ndërhy në formularin e për dorëzimin e ofertës përkatësisht në pjesën C formulari për dorëzimin e ofertës është pjesa Kryesore e dosjes së tenderit.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues, sqaron se OE i rekomanduar për kontratë paramasën e ofruar me çmimet e plotësuar, tek Rekapitulimi punët ndërtimore OE i rekomanduar për kontratë ka shtuar rreshtin me pozicionin 1.16, Shih në vijim grafikun.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë ka krijuar një kolonë të re nga ajo që është ofruar nga AK.

Eksperti Shqyrtues sqaron se paramasa e ofruar nga AK është dokument që duhet të vlejë për të gjithë operatorët ekonomik njëloj dhe asnjë OE nuk u lejohej të ndërhyj apo të ndryshojnë nga paramasa e AK-së.

Po ashtu, AK nuk ka dhënë arsyetim në pretendimet ankimore në kërkesën për rishqyrtim dhe eksperti shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në kundërshtim me paragrafin 9 të Nenit 108/A të LPP-së.

Eksperti Shqyrtues, e sheh pretendimin e OE ankues si të bazuar, dhe rekomandon që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlersim dhe rivlerësimit të bëhet në plotni me dispozitën e nenit 59 të LPP-së dhe të ketë parasysh Nenin 1, Nenin 6, Nenin 7 të LPP-së

Palët janë në dijeni lidhur me shkresat e kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores së cituar dhe konstatohet se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP. Prandaj Paneli analizoi në vijim shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe pohimet e tyre konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme dhe ka kushte të vendoset në mënyrë meritore përkitazi me ankesën në rastin konkret, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik. Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore.

Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë përbëjnë bazë të mjaftueshme aktivitetit i prokurimit anulohet në tërësi, në të kundërtën çdo vendim ndryshe, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP që ndërlidhet me nenin 1 dhe nenin 7 të parimit barazia në trajtim/jo-diskriminim, si dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore dhe pohimeve të AK, të cilat Paneli sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Anulimi në tërësi i këtij aktiviteti të prokurimit duke pasur parasysh natyrën e këtij aktiviteti dhe gabimet të cilat i ka bërë AK në përpilimin e Dosjes së Tenderit/Përshkrimi i çmimeve, gabime në përshkrim të çmimeve të cilat janë të evidentuara në raportin e ekspertizës por të cilat janë të evidentuara nga pohimet ankimore dhe në njoftimin mbi

vendimin e AK (B58), ku të gjithë OE detyrimisht është dashtë me plotësu këtë përshkrim të çmimeve me gabime, dmth gabim i pashmangshëm dhe është shumë e vështirë të quhet edhe ndërhyrje (shumica e OE janë eliminuar për gabime në paramasë, duke përfshirë edhe gabime të cilat i ka bërë edhe OE i rekomanduar për kontratë por edhe i vetmi OE i cili është eliminuar për tejkalim të vlerës së parashikuar). Andaj, vlerësimi më i drejtë i kësaj lënde dhe me qëllim që asnjë OE mos të dëmtohet atëherë paneli shqyrtues vendosi që ky aktivitet i prokurimit të anulohet për shkak se AK nuk ka hartuar DT konform nenit 27 të LPP si dhe nenin 17.12 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, citat: *"Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre"*. Këtu një pjesë të fajit e bartin edhe OE pjesëmarrës të cilët këtë gabim nuk e kanë evidentuar me kohë dhe me kërkim që të rregullohet nga ana e AK.

Paneli sipas gjykimit të pavarur konsideron se ky veprim është marrë në harmoni me nenin 7 të LPP lidhur me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Po ashtu duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për panelin shqyrtues dhe çdo raport i tillë vlerësohet dhe analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, pohimeve të palëve, akteve dhe veprimeve të tyre, natyrisht duke e pasur parasysh edhe natyrën e shkeljeve eventuale në raport me qëllimin dhe rrjedhën e një aktiviteti të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli Shqyrtues nëse e mbështet ndonjë raport apo ndonjë rekomandim të ekspertizës, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të panelit ashtu siç i adresohen kompetencat e tilla sipas nenit 105 të LPP. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet në tërësi.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - MBB Construction SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: